



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 351, Datë 28.12.2022

MBI

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KERKESËN E SHOQËRISE “KURUM INTERNATIONAL” SH.A., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 132, DATË 06.12.2011 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S DHE TRANSFERUAR ME VENDIMIN NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S TEK SHOQËRIA “KURUM INTERNTIONAL” SH.A. PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “SHKOPET”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10 pika 3 dhe nenit 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE- s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/11 prot., datë 23.12.2022 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për modifikimin e e licencës shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a, për modifikimin e licencës nr. 213, Seria pm13p, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të bordit të komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “KURUM INTERNTIONAL” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga hec-i “Shkopet”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2093 prot., datë 16.12.2022, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC “Shkopet”.
- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se në Maj 2023 kjo shoqëri ka programuar rehabilitimin e HEC “Shkopet”, “optimizimi i operimit të turbinave”, gjatë të cilit do të zëvendësohen disa nga pajisjet kryesore të centralit dhe do të instalohen pajisje të reja dhe do të ketë një shtesë kapaciteti prej 4 MW dhe fuqia nominale do të jetë $P_n=28$ MW.

- Me vendimet e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 132/2011 “Për licencimin e shoqërisë “HEC ULEZ – SHKOPET” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Ulez dhe Shkopet”, dhe nr. 136/2011, “Për licensimin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, licencat që mbanin shoqëritë “HEC Ulez – Shkopet” sh.p.k. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.p.k. janë transferuar tek shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a.
- HEC “Shkopet” është ndërtuar në vitin 1957 në lumin e Matit në qytetin e Burrelit- Rrethi Dibër dhe me ligjin nr. 94/2013, datë 04.03.2013, “Për ratifikimin e kontratës së shtijes së 100 % të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz – Shkopet” sh.a. të lidhur ndërmjet METE-s (sot MIE) dhe shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a..”, është ratifikuar kontrata për shitjen e 100% të aksioneve nga shoqëria “HEC Ulez – Shkopet” sh.a. tek shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., duke kaluar HEC Shkopet në pronësi të “KURUM INTERNATIONAL” sh.a.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
Neni 15, “Modifikimi i Licencës”, Pika 4, gërmat “a”, “b” dhe “d”. Plotësuar
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:
Neni 15, “Modifikimi i Licencës”, Pika 4
 - **gërma “c”**. Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores.
 - **gërma “e”** Shoqëria duhet të depozitonte dokumentin përkatës mbi miratimin/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 MW.
 - **gërma “f”** Shoqëria duhet të depozitonte miratimin/qëndrimin përkatës të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 MW.
 - **gërma “g”** Shoqëria duhet të depozitonte në ERE qëndrimin/miratimin përkatës të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në lidhje me kapacitetin e ri të kërkuar për modifikim prej 28 MW.
- Në kuadër të mosplotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për alikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, date 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet” me kapacitet të instaluar 24 MW.
2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për alikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI